

**Nr. Prot. 010/B/20**

## **VENDIM Nr. 1497**

**Për**

### **Vazhdimin e procesit të Konsultimit Publik të Draft Rregulloreve për Qasje dhe Interkoneksionin në Rrjetet e komunikimeve elektronike**

Në mbështetje të nenit 1, nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.3), nenit 10, paragrafi 4), nenit 33, nenit 34, neni 36, neni 37, nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe nenit 82, paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 2) z. Hazir Hajdari, Anëtar
- 3) z. Bahri Anadolli, Anëtar, dhe
- 4) z. Shqiprim Pula, Anëtar,

në mbledhjen e 52-të me radhë të mbajtur më datë 31 Janar 2020, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe rekomandimit të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamentit Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

## **V E N D I M**

- I. Miratohet vazhdimi i Konsultimit Publik të dokumenteve:
  - a. **Draft Rregullorja për Shërbimin e Interkoneksionit në rrjetat e komunikimeve elektronike;**
  - b. **Draft Rregullorja për Qasjen e Hapur në Lakun Lokal ose pjesë të tij;**
  - c. **Draft Rregullorja për Oferten Referente për Qasjen e Hapur në Lakun Lokal dhe Bitstream.**
- II. Procesi i konsultimit publik vazhdon deri më datë **25 Shkurt, 2020.**
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Neni 1 i Ligjit specifikon qëllimin e Ligjit si në vijim:

“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t’i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

ARKEP me Vendimet: Vendimi Nr.1470 (Ref. Nr.Prot.119/B/19), Vendimi Nr.1471 (Ref. Nr.Prot.120/B/19), dhe Vendimi Nr.1472 (Ref. Nr.Prot.121/B/19), të datës 10/12/2019 ka miratuar fillimin e konsultimit publik të draft Rregulloreve:

- Draft Rregullorja për Shërbimin e Interkoneksionit në rrjetat e komunikimeve elektronike;
- Draft Rregullorja për Qasjen e Hapur në Lakun Lokal ose pjesë të tij;
- Draft Rregullorja për Oferten Referente për Qasjen e Hapur në Lakun Lokal dhe Bitstream.

Pas shqyrtimit të kërkesës së operatorëve Telekom i Kosovës sh.a. dhe IPKO Telecommunications LLC, duke marrë për bazë rëndësinë e rregulloreve në rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike, si dhe marrë parasyshë faktin se ARKEP nuk ka pranuar asnjë koment nga palët e intresit,

Atëherë, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 10/02/2020**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Aktvendimi i dërgohet:**

- Ofruesve të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike,
- Departamentit Ligjor,
- Arkivës së Autoritetit.